REPUBLIKA E KOSOVË/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. 01-3642/15
Data 27.10.2015

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	26.10.2015
REFERENC-Ë:	*DPK- DPKPP 03-03-3355/15*
PËR/ZA/TO:	z. Bajram ALIJAJ u.d. Menaxher i Zyrës së Prokurimit në INFRAKOS sh.a.
CC:	z. Agron THAÇI Kryeshef Ekzekutiv në INFRAKOS sh.a.
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " **Sigurimi fizik i hapësirave të Infrakos-it** "

REPUBLIKA E KOSOVË
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
ANTI-CORRUPTION AGENCY
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
REPUBLIKA KOSOVA

I nderuari z. Alijaj ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin " Sigurimi fizik i hapësirave të Infrakos-it " me numër prokurimi IK026-15-026-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Në lidhje me monitorimin e procesit rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit publik me titull " Sigurimi fizik i hapësirave të Infrakos-it " me numër prokurimi IK026-15-026-221, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Infrakos sh.a.

A r s y e t i m i

Agjencia Kundër Korrupsionit me dt.15.10.2015 ka nxjerrë vendim për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull ***" Sigurimi fizik i hapësirave të Infrakosit " me nr. të prokurimit IK026-15-026-221*** i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Infrakos sh.a.
Me dt. 19.10.2015 Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur njoftimin zyrtar për pjesëmarrje në vëzhgim pranë Autoritetit Kontraktues të cilin e ka njoftuar se Zyrtari i AKK-së do të merr pjesë si vëzhgues në procesin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve. Zyrtari përgjegjës i AKK-së pasi ka analizuar dokumentet përbërëse të këtij tenderi dhe ka analizuar me kujdes procesin e vlerësimit të tenderëve ka konstatuar faktet si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej *10* Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar *4* OE.

Komisioni për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave të të Operatorëve Ekonomik ka konstatuar se të gjithë tenderuesit që kanë ofertuar për këtë kontratë kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm në pajtim me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, andaj Komisioni vlerësues konstatoi dhe erdhi në përfundim se Operatori ekonomik i renditur në numrin 1 në raportin e vlerësimit të tenderëve i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe ka ofruar çmimin më të lirë, andaj rekomandoi lidhjen e kontratës me këtë Operator ekonomik.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka ekzaminuar dhe analizuar me kujdes dokumentacionin në dispozicion lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderit konstaton se procesi i prokurimit deri në këtë fazë është kryer në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik, andaj nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohej ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të procedojë me këtë aktivitet të prokurimit konform Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !